



Pranuar / Dorezuar Pamthjen / Primalo Received / Delivered	19-04-2023	3	viti god year
Organ / Mjesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK/3691/2023			1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.459/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.459/2023 të datës 06.03.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komunës së Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.04.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

*Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.459/2023 e datës 06.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 06.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër reference 01-120/08-0013010-2/23 të datës 21.02.2023 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për shtesat mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës, me pretendimin së përgjigja është dhënë më shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale si dhe diskriminimit në të drejtën e rimbursimit në formë retroaktive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit Komuna e

Mitrovicës së Jugut, ndërsa, kjo e fundit më datë 13.04.2023 ka përcjell shkresat lidhur me ketë çështje ankimore.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 2352/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër 01-120/08-0013010-2/23 të datës 21.02.2023 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut; Ndryshim dhe Plotësimin e aktit të emërimit nën shenjë . .Nr.01-112/01-0106752/22 të datës 30.11.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 21.02.2023; Akt emërimit e datës 30.07.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Komunale e Transportit Rrugor; Vendimin me numër A.nr.864/2022 te datës 07.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2710/2023 të datës 15.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3541/2023 të datës 13.04.2023; Kërkuesen me numër të referencës 01-120/08-0013010/23 të datës 15.02.2023 për pagesë retroaktive; Listën e pagave për muajin Shkurt-2023; Listën e pagave për muajin Mars-2023;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike. I njëjti më datë 05.10.2022 ka kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.864/2022 të datës 07.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'i harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut më datë 30.11.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimit .Nr.01-112/01-0106752/22 më koeficient tetë (8).

Ankuesi më datë 15.02.2023 ka parashtruar kërkesë të Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së një koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga viti 2015 e tutje. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 21.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 15.02.2023 me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 21.02.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ankuesi me datë 06.03.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës se koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin retroativ te diferenczws sw koeficientit, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedhë se ankuesi me datë 30.07.2012 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës *Inspektor i Shërbimeve Komunale* me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndër marr asnjë veprim juridik në kuptim të

harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 05.10.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 30.07.2012), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohet se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.459/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

